VENDIM

Nr. 119, datë 13.2.2020

PËR PROCEDURAT E PAGESËS DHE TË RIVLERËSIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË JANË NË PROCES REGJISTRIMI, DUKE PËRFSHIRË EDHE PASURITË E LEGALIZUARA, NË PËRPUTHJE ME LIGJIN NR. 90/2019, "PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të ligjit nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJ-TSHME NË PROCES REGJISTRIMI PËR INDIVIDËT

1. Të gjithë individët dhe personat juridikë, të cilët kanë në proces regjistrimi pasuri të paluajtshme (tokë dhe/ose ndërtesë) pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim "ASHK"), përshirë edhe lejet e legalizimit, sipas ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", apo do të aplikojnë për regjistrimin e tyre brenda datës 30.9.2020, kanë të drejtë që, brenda këtij afati, të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut, sipas ligjit nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme".

2. Individi mund të zgjedhë vullnetarisht nëse rivlerësimin e pasurisë do ta bëjë ASHK-ja apo një ekspert i vlerësimit të pasurive, i licencuar nga institucionet përkatëse. Për të përfituar nga rivlerësimi, nëpërmjet pasqyrimit të tij në regjistrin e pasurive të paluajtshme, individi duhet të paguajë më parë tatimin e rivlerësimit (3 (tre) % e bazës së tatueshme) dhe tarifën e shërbimit.

3. Në rast se individi ka aplikuar apo do të aplikojë, brenda datës 30.9.2020, për të regjistruar më shumë se një pasuri të paluajtshme dhe do të bëjë rivlerësimin e secilës prej tyre, procedura e rivlerësimit është individuale për secilën prej këtyre pasurive.

4. ASHK-ja vijon me trajtimin e aplikimit për rivlerësimin e pasurisë në proces regjistrimi dhe llogaritjen e tatimit 3%, nëse dokumentacioni i paraqitur për regjistrimin e pasurisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme është në përputhje me ligjin nr. 111/2018, "Për kadastrën".

II. LLOGARITJA E BAZËS SË TATUESHME PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË NË PROCES REGJISTRIMI PËR INDIVIDËT

5. Në rast se individi zgjedh që rivlerësimin e pasurisë ta bëjë drejtoria vendore e ASHK-së, kjo do të bëhet me çmimet referuese të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi, në momentin e kryerjes së procesit të rivlerësimit të pasurisë në proces regjistrimi dhe sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018, "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme", dhe konkretisht:

5.1 Nëse pasuria në proces regjistrimi nuk ka të përcaktuar vlerën në aktin e fitimit të pronësisë, atëherë baza e tatueshme llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së rivlerësimit, sipas çmimeve referuese, në përputhje me aktin nënligjor në fuqi, dhe vlerës së zbritshme. Në këtë rast, si vlerë

e zbritshme për ndërtesat do të merret vlera e kostos së shfrytëzimit për metër katror, e përcaktuar nga akti nënligjor në fuqi (udhëzimi përkatës i Këshillit të Ministrave), në momentin e aplikimit për regjistrim të pasurisë së paluajtshme. Ndërkohë, si vlerë e zbritshme për tokën do të merret vlera sipas çmimeve të hartës së vlerave në fuqi, korrektuar me indeksin e inflacionit, sipas udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018, "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme".

5.2 Nëse pasuria në proces regjistrimi ka të përcaktuar vlerën në aktin e fitimit të pronësisë, atëherë baza e tatueshme llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së rivlerësimit, llogaritur me çmimet referuese, sipas aktit nënligjor në fuqi, dhe vlerës së pasurisë së pasqyruar në aktin përkatës të fitimit të pronësisë që evidenton pasurinë e paluajtshme.

6. Në rast se individi zgjedh që rivlerësimin e pasurisë ta bëjë një ekspert i licencuar, kur:

6.1 Pasuria në proces regjistrimi nuk ka të përcaktuar vlerën në aktin e fitimit të pronësisë, atëherë baza e tatueshme llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së pasqyruar në aktin e vlerësimit nga vlerësuesi (eksperti), me vlerën sipas kostos së shfrytëzimit për metër katror, e përcaktuar nga akti nënligjor në fuqi (udhëzimi përkatës i Këshillit të Ministrave) në momentin e aplikimit për regjistrim të pasurisë së paluajtshme. Ndërkohë, si vlerë e zbritshme për tokën do të merret vlera, sipas çmimeve të hartës së vlerave në fuqi, korrektuar me indeksin e inflacionit, sipas udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018, "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme".

6.2 Pasuria në proces regjistrimi ka të përcaktuar vlerë në aktin e fitimit të pronësisë, atëherë baza e tatueshme llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së pasqyruar në aktin e vlerësimit nga vlerësuesi (eksperti) dhe vlerës së pasurisë së pasqyruar në aktin përkatës të fitimit të pronësisë që evidenton pasurinë e paluajtshme.

7. Si moment për llogaritjen e bazës së tatueshme për pasuritë, të cilat janë në proces regjistrimi, do të konsiderohet data e aplikimit për regjistrim në ASHK.

III. PARAQITJA DHE ADMINI STRIMI I KËRKESËS PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË NË PROCES REGJISTRIMI NGA INDIVIDËT

A. Aplikimi online

8. Individi ose përfaqësuesi i tij aplikon online për shërbimin e rivlerësimit të pasurisë në proces regjistrimi, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania. Në mënyrë që të pajiset me dokumentin zyrtar, që pasqyron regjistrimin e rivlerësimit, ai duhet të aplikojë edhe për shërbimin e pajisjes me kopje të kartelës së pasurisë së paluajtshme, ose të vërtetimit (për pasuritë që nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar).

Aplikimi për shërbimet i drejtohet drejtorisë/zyrës vendore të ASHK-së që është kompetente për territorin ku po regjistrohet pasuria e paluajtshme.

9. Individi që aplikon online për rivlerësimin e pasurisë në proces regjistrimi duhet të plotësojë në rubrikat përkatëse të platformës e-Albania të dhënat identifikuese të pasurisë në proces regjistrimi që kërkohet të rivlerësohet. Nëse individi nuk plotëson rubrikat që identifikojnë pasurinë, ai duhet detyrimisht të ngarkojë në platformë kopje të skanuar të dokumentit të pronësisë që disponon për pasurinë.

10. Punonjësi i drejtorisë vendore të ASHK-së shqyrton aplikimin, duke verifikuar:

a) identifikimin e pasurisë, sipas përcaktimeve të pikës 9, të këtij kreu; dhe

b) legjitimimin e individit aplikues. Punonjësi verifikon nëse individi që ka paraqitur kërkesën për rivlerësim (ose i përfaqësuari) është pronar apo një nga bashkëpronarët e pasurisë që kërkohet të rivlerësohet;

c) nëse dokumentacioni i paraqitur për pasurinë në proces regjistrimi është në përputhje me ligjin nr. 111/2018, "Për kadastrën".

Nëse nuk përmbushen kushtet e mësipërme, individi njoftohet nëpërmjet platformës, për të identifikuar pasurinë ose për mosvijimin e aplikimit me arsyet përkatëse.

11. Nëse aplikimi i përmbush kushtet e pikës 10, të këtij kreu, dhe dokumentacioni i regjistrimit të pasurisë është në përputhje me ligjin nr. 111/2018, vijohet me llogaritjen e tatimit të rivlerësimit, sipas rregullave të kreut II, të këtij vendimi, duke hartuar faturën për arkëtim.

12. Fatura për arkëtim plotësohet sipas modelit të shtojcës nr. 3 që i bashkëlidhet vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij. Fatura nënshkruhet dhe vuloset elektronikisht nga drejtoria vendore e ASHK-së dhe, së bashku me tarifat e shërbimit, i dërgohet aplikuesit nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania.

13. Përjashtimisht, kur individi kërkon rivlerësimin, sipas aktit të ekspertit të licencuar, dërgimi, nëpërmjet platformës, i faturës së tatimit të nënshkruar dhe të vulosur elektronikisht, së bashku me tarifën e shërbimit, kryhet vetëm pasi të jetë administruar fizikisht (me postë) akti origjinal i vlerësimit të pasurisë, nënshkruar dhe vulosur nga eksperti vlerësues i pasurisë, si dhe fotokopja e njësuar e licencës së tij. Për këtë, individi, krahas aplikimit online, duhet të dërgojë me postë në zyrën/drejtorinë vendore të ASHK- së dokumentacionin fizik të mësipërm.

14. Pasi të jetë verifikuar shlyerja e pagesës së tatimit të rivlerësimit dhe të tarifave të shërbimit, aplikimi i individit konsiderohet i plotësuar dhe ASHK-së i lind detyrimi që, përveç regjistrimit të pasurisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme, të bëjë edhe pasqyrimin e rivlerësimit në regjistrin e pasurive, sipas rregullave të parashikuara në kreun VI, të këtij vendimi.

B. Aplikimi në sportel

15. Përjashtimisht, në rastet kur është e pamundur të administrohet aplikimi nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, aplikimi kryhet pranë zyrës pritëse (sportelit) në drejtorinë/zyrën vendore kompetente ku është në proces regjistrimi i pasurisë, duke paraqitur "Kërkesën për rivlerësim", sipas formularit, shtojca nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Në mënyrë që të pajiset me dokumentin zyrtar që pasqyron regjistrimin e rivlerësimit, individi duhet të aplikojë edhe për shërbimin e pajisjes me kopje të kartelës së pasurisë së paluajtshme ose të vërtetimit (për pasuritë që nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar).

16. Individi apo përfaqësuesi i tij me prokurë, në çdo rast, paraqitet me dokument identifikimi pranë zyrës pritëse të ASHK-së. Ai pajiset me dy kopje të paplotësuara të formularit "Kërkesë për rivlerësim" nga punonjësi përgjegjës.

16.1 Individi apo përfaqësuesi i tij me prokurë plotëson dy pikat e para të formularit. Të dhënat e plotësuara në formular dhe në dokumentacionin bashkëlidhur (kopje të dokumentit të pronësisë) verifikohen sipas përcaktimeve të pikës 10, të kreut III, të këtij vendimi.

16.2 Në rast përputhjeje të të dhënave, punonjësi përgjegjës plotëson pikën 3, të formularit, me vlerën e zbritshme.

16.3 Punonjësi llogarit tatimin që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi, sipas kreut II, të këtij vendimi, duke plotësuar pikën 4, të formularit, "Kërkesë për rivlerësim".

16.4 Pas plotësimit të të gjitha pikave të mësipërme të formularit "Kërkesë për rivlerësim", punonjësi përgjegjës e nënshkruan atë dhe një kopje ia jep individit ose përfaqësuesit të tij. Individi ose përfaqësuesi i tij, pajiset gjithashtu me faturën për arkëtim (shtojca nr. 3) për pagesën e tatimit, si dhe për tarifat e shërbimit.

16.5 Individi, pasi paguan në bankë tatimin dhe tarifën e shërbimit, dorëzon vërtetimin e pagesës së tyre pranë drejtorisë vendore të ASHK-së. Vërtetimi i pagesës i bashkëlidhet formularit të aplikimit.

16.6 Pas kryerjes së pagesës së tatimit dhe tarifave të shërbimit, aplikimi konsiderohet i plotësuar dhe drejtorisë vendore i lind detyrimi që, përveç regjistrimit të pasurisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme, të bëjë edhe pasqyrimin e rivlerësimit në regjistrin e pasurive, sipas rregullave të parashikuara në kreun VI, të këtij vendimi.

IV. RIVLERËSIMI I PASURISË SË PALUAJTSHME NË PROCES REGJISTRIMI PËR PERSONAT JURIDIKË

17. Personat juridikë, të cilët kanë të regjistruara në pasqyrat financiare të vitit 2019, në zërin "aktive afatgjata materiale", pasuri të paluajtshme me vlerë kontabël më të vogël se vlera e tregut, dhe janë në proces regjistrimi të tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë ASHK-së, kanë të drejtë të bëjnë, brenda periudhës së zbatimit të këtij ligji, rivlerësimin e këtyre pasurive të paluajtshme me vlerën e tregut. Rivlerësimi me vlerën e tregut bëhet nga vlerësues të pasurisë, ekspertë të pavarur të licencuar nga institucionet përkatëse për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme.

18. Procedura e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme në proces regjistrimi të personave juridikë kryhet, si më poshtë vijon:

18.1 Përfaqësuesi i personit juridik paraqet pranë drejtorisë rajonale tatimore, ku personi juridik është i regjistruar, këto dokumente:

a) deklarimin vullnetar për rivlerësimin e pasurisë, sipas shtojcës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) prokurën për përfaqësuesin ligjor, nëse kjo procedurë kryhet nga një përfaqësues ligjor i caktuar prej tij;

c) kopjen e licencës së ekspertit të pavarur të vlerësimit të pasurisë;

ç) kopjen e faturës së shërbimit të ekspertit të vlerësimit të pasurisë;

d) aktin origjinal të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruar dhe të vulosur nga vlerësuesi i pasurisë;

dh) dokumentin e lëshuar nga drejtoria vendore e ASHK-së, ku evidentohet se pasuria e paluajtshme e personit juridik që rivlerësohet është në proces regjistrimi pranë kësaj drejtorie;

e) pasqyrën financiare (bilancin kontabël) të vitit 2019, ku rezulton e regjistruar në zërin "aktive afatgjata materiale", pasuria e paluajtshme që rivlerësohet, përfshirë anekset shpjeguese për aktivin afatgjatë material që rivlerësohet;

ë) kopjen e mandatit të pagesës për vlerësimin e pasurisë, në masën 5 (pesë) % të diferencës ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël për pasuritë e paluajtshme të regjistruara në pasqyrat financiare. Pagesa kryhet në njërën nga bankat e nivelit të dytë për llogari të thesarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas formatit të faturës së arkëtimit, shtojca nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Personi juridik mban një kartelë të pasurisë së paluajtshme, ku evidenton vlerën përkatëse të pasurisë së paluajtshme që nga momenti i njohjes fillestare të aktivit dhe tatimin përkatës, paguar sipas legjislacionit në fuqi.

18.2 Data e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme konsiderohet data e pagesës së kryer, siç përcaktohet në pikën 4, të nenit 3, të ligjit nr. 90/2019.

18.3 Diferenca midis vlerës që rezulton nga rivlerësimi, sipas aktit përkatës të ekspertit dhe vlerës kontabël të regjistruar në pasqyrat financiare regjistrohet përkatësisht në zërin përkatës të pasqyrave financiare, në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, si dhe në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar. Kjo vlerë nuk është objekt amortizimi për qëllime tatimore.

18.4 Pasqyrave financiare për rivlerësimet që kryhen brenda periudhës gjatë së cilës i shtrin efektet ligji nr. 90/2019, sipas nenit 5, të tij, u bashkëlidhen pasqyrat analitike të vlerës kontabël të pasurive të paluajtshme të rivlerësuara.

V. PAGESA E TË ARDHURAVE NGA RIVLERËSIMI I PASURISË SË PALUAJ- TSHME NË PROCES REGJISTRIMI NË BUXHETIN E SHTETIT

19. Pagesa e tatimit nga rivlerësimi i pasurive të paluajtshme në proces regjistrimi kryhet pranë bankave të nivelit të dytë, sipas formularit "Fatura për arkëtim", sipas modelit të shtojcës nr. 3 dhe të shtojcës nr. 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

20. Formulari u vihet në dispozicion klientëve- individë nga drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-së dhe klientëve-persona juridikë nga drejtoritë rajonale tatimore. Gjithashtu, ky formular mund të shkarkohet edhe elektronikisht në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

21. Fatura për arkëtim, e plotësuar sipas këtij vendimi, nënshkruhet nga klienti. Për personin juridik është e detyrueshme që, përveç të dhënave të nënshkruesit, të plotësohen gjithashtu emri i personit juridik (shoqërisë) dhe NIPT-i/NUIS-i. Pas verifikimit për p lotësimin e të dhënave të plota, banka, në zbatim të marrëveshjes dypalëshe me Ministrinë e Financave dhe

Ekonomisë, pranon të kryejë arkëtimin, duke evidentuar llojin e të ardhurës, si dhe kodin e institucionit, sikurse është përcaktuar në "Faturën për arkëtim", në bazë të kodit të të cilit do të kryhet kontabilizimi në sistemin informatik financiar të qeverisë (në vijim "SIFQ").

22. Arkëtimi i këtyre të ardhurave do të kryhet në llogarinë bankare të të ardhurave të thesarit, në emër të institucionit të drejtorisë/të zyrës vendore të ASHK-së. Drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-së do të operojnë si agjentë tatimorë për arkëtimin në buxhetin e shtetit të këtyre të ardhurave. Për këtë qëllim, në SIFQ do të çelen kodet e institucionit në grupin 80 për çdo drejtori/zyrë vendore të ASHK- së. Kontabilizimi i tatimit nga rivlerësimi i pasurisë së personave juridikë (5%) do të bëhet në llogarinë ekonomike të të ardhurave 7020400, ndërsa kontabilizimi i tatimit nga rivlerësimi i pasurisë së individëve (3%) do të bëhet në llogarinë ekonomike të të ardhurave 7020800.

23. Banka transferon arkëtimet në llogaritë bankare përkatëse, në emër të Degës së Thesarit të çdo rrethi për çdo drejtori vendore, sipas kodeve përkatëse të çdo drejtorie.

24. Drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-së çdo muaj bëjnë rakordimin me degën e thesarit për arkëtimet e kryera, në përputhje me këtë vendim.

25. Në raste të derdhjeve gabim dhe të detyrimit për të kthyer sërish ose pjesërisht shumën e derdhur gabim, drejtoria vendore e ASHK-së do të paraqesë urdhërpagesën së bashku me dokumentet justifikuese pranë degës së thesarit respektive për kthimin e shumës tek individi/personi juridik përfitues i kësaj shume. Për këtë qëllim, çdo drejtori vendore e ASHK-së duhet të miratojë në strukturën përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nëpunësin e saj autorizues dhe atë zbatues, për nënshkrimin e urdhërpagesës, si dhe depozitimin e firmave të autorizuara në degën e thesarit.

VI. TARIFA E KRYERJES SË SHËRBIMIT DHE DISPOZITA TË TJERA

26. Tarifa për kryerjen e shërbimit të rivlerësimit pranë ASHK-së, për pasuritë e paluajtshme në proces regjistrimi, është në masën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë dhe do të ketë kodin RVP në formularin e aplikimit.

27. Procedurat për pasqyrimin e rivlerësimit të pasurisë, në proces regjistrimi në regjistrat e pasurive të paluajtshme, kryhen sipas dispozitave të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së, "Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme" dhe përcaktimin e tarifës së shërbimit".

28. Aplikimet për rivlerësim të pasurive që janë në proces regjistrimi, për të cilat është shlyer tatimi brenda datës 30.9.2020, trajtohen e përfundohen edhe pas kësaj date.

29. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

SHTOJCË NR. 1

FORMULAR "KËRKESË PËR RIVLERËSIM" (PËR INDIVIDËT)

Drejtuar: Drejtorisë/zyrës vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

1. Të dhënat e aplikuesit

Emri/atësia/mbiemri i aplikuesit:

Numri i identifikimit në kartën e identitetit , lëshuar nga

Data e lëshimit:

Adresa e banimit , adresa e dytë (nëse ka)

2. Të dhënat e pasurisë së paluajtshme

Në përputhje me ligjin nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", aplikoj për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme.

Lloji i pasurisë së paluajtshme (tokë/ndërtesë)

Numri i regjistrimit në zyrën kadastrale , sipërfaqja në m2 (me shifra dhe me fjalë)

m2

Data e regjistrimit në ASHK:

Çmimi i blerjes së pasurisë, bazuar në kontratën e shitblerjes/vlera e rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi

(me shifra dhe me fjale për t'u plotësuar nga ASHK-ja)

3. Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme

3.1 Në rast se kryhet nga ASHK-ja

Vlera e pasurisë në vitin 2020, sipas çmimeve minimale fiskale ne fuqi

(në shifra dhe me fjalë)

3.2 Në rast se kryhet nga eksperti i pasurisë

Vlera e pasurisë në vitin 2020, sipas aktit të ekspertimit

(me shifra dhe me fjalë)

4. Tatimi për t'u paguar

4.1 Baza e tatueshme = (vlera e dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale në fuqi minus vlerën e pasurisë së aktit të regjistruar apo vlerën e rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi)

Tatimi = (3% e bazës së tatueshme)

4.2 Baza e tatueshme = (vlera e tregut të pasurisë së pasqyruar në akt ekspertimi (jo më e vogël se çmimi minimal fiskal) minus vlerën e pasurisë, sipas aktit të regjistruar apo vlerës së rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi)

Tatimi = (3% e bazës së tatueshme)

Data dhe nënshkrimi i aplikuesit:

Aplikimi është marrë nga personi i autorizuar nga ASHK-ja:

SHTOJCË NR. 2

DEKLARIMI VULLNETAR PËR RIVLERËSIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME TË PERSONAVE JURIDIKË

Drejtuar: Drejtorisë Rajonale të Tatimeve:

Deklarim vullnetar për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme

Unë znj/z përfaqësuesi i personit juridik

me NIPT/NUIS , me adresë ,pajisur me autorizim

për përfaqësim , deklaroj se, në bazë të ligjit nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së

paluajtshme", deklaroj vullnetin tim për të kryer rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme të regjistruar në pasqyrën financiare (bilanci kontabël) të periudhës .

Baza e tatueshme = (diferenca midis vlerës që rezulton nga rivlerësimi, sipas aktit të ekspertit dhe vlerës kontabël të regjistruar në pasqyrat financiare (në shifra dhe fjalë))

Pagesa =5% x bazën e tatueshme

Emri/mbiemri:

(nënshkrimi)

Data:

SHTOJCË NR. 3

FATURË PËR ARKËTIM

Nr. , datë

Bankës

Me anë të kësaj fature kërkojmë që banka juaj të pranoje nga klientë (individë) arkëtime të të ardhurave, për llogari të buxhetit të qeverisjes së përgjithshme, me emërtimet, kodin dhe shumat përkatëse, si më poshtë:

Kodi i llogarisë ekonomike ku do të derdhet tatimi nga rivlerësimi është

Emri institucionit: Drejtoria vendore e ASHK-së

Numri i llogarisë dhe IBAN për RVP:

Kodi i degës së thesarit:

Nr. Përshkrimi i të ardhurave/emërtimi Mënyra e përllogaritjes Shuma që arkëtohet (lekë) Nr. llogarisë së DVASHK-së për RVP-në

1 ... Tatim nga rivlerësimi i pasurisë së individëve (3%) të bërë nga ASHK 3% e (vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale

- (minus)

vlerën e pasurisë së aktit të regjistruar/të rivlerësuar)

2 ... Tatim nga rivlerësimi i pasurisë së individëve (3%) të bërë nga eksperti vlerësues i licencuar 3% e (vlerës së dalë nga akti i ekspertimit, jo më pak se çmimet minimale fiskale

-(minus)

vlerën e pasurisë sipas aktit të regjistruar, /të rivlerësuar)

DREJTORIA VENDORE E ASHK-së KLIENTI

Emër/mbiemër/firmë Individ

Emër/mbiemër

SHTOJCË NR. 4

FATURË PËR ARKËTIM

Nr. , datë

Bankës

Me anë të kësaj fature kërkojmë që banka juaj të pranojë nga klientë (persona juridike/individë) arkëtime të të ardhurave, për llogari të buxhetit të qeverisjes së përgjithshme, me emërtimet, kodin dhe shumat përkatëse, si më poshtë:

Kodi i llogarisë ekonomike ku do të derdhet tatimi nga rivlerësimi është

Emri institucionit përfitues (teknik): Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme

Kodi i institucionit përfitues: Sipas kodeve përkatëse të çdo rrethi

Kodi i degës së thesarit: Sipas kodeve përkatëse të çdo rrethi.

Nr. Përshkrimi i të ardhurave/emërtimi Kodi i llogarisë ekonomike Shuma që arkëtohet (lekë)

1 ... Tatim nga rivlerësimi i pasurisë së personave juridikë (5%)

KLIENTI

Person juridik

NIPT/NUIS

Administratori/përfaqësuesi

Emër/mbiemër/nënshkrimi

Adresa:

Kontakti: